

UDHËZIM

Nr.3, datë 2.2.2010

PËR FORMATIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI LOJËRAT E FATIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 64, pika 4 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Miratimin e formularit të Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Lojërat e Fatit, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 2. Ky formular do të shtypet në dy (2) kopje, shtypja do të bëhet me letër vetëkopjuese. Dimensionin e formatit është: A4, me udhëzues traktor. Formulari do të prodhohet në faqe të formatit "Letër" si formularët e tjere "traktor". Shënimet sqaruese për plotësimin e këtij formulari do të jenë vetëm në pjesën e prapme të kopjes së dytë.
 3. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.23, datë 5.3.2009 "Për formatin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit", shfuqizohet.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode